



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKISË

Nr. 4475 Prot

Ballsh, më 01.09.2026

VENDIM

Nr. 42 Datë 28/08 2026

“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z. Ramadan Meçaj, banorë i fshatit Rriban, Njësia Administrative Ngraçan, Bashkia Mallakastër, banesa 1 (një) katëshe e të cilit është dëmtuar si pasojë e një zjarri rënë më datë 07.07.2026”.

Baza ligjore

- Ligji Nr.139/2015 date, 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore".
- Ligji Nr.107/2016 date 27.10.2016 "Per Prefektin e Qarkut".
- Ligji Nr.45, date 18.07.2019 "Per Mbrojtjen Civile".
- V.K.M. nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat dhënies se ndihmës shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesit natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër për mbështetje financiare të qytetarit Ramadan Meçaj, banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë e zjarrit të rënë më datë 07.07.2026.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar nga ana e Bashkisë Mallakastër.
3. Miratimin e vlerës totale prej 382.900 (treqindë e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind) lekë. dëme në orendi shtëpiake.

Miratimin e vlerës në masën prej 50 %, 89.148 (tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzetë e tetë) lekë, e vlerës totale prej 178.297 (njëqindë e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqindë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, dëme nga ana ndërtimore.

Totali i vlerës (nga ana e orendive shtëpiake + 50 % nga ana ndërtimore pa TVSH) është 472.047 (katërqindë e shtatëdhjetë e dy mijë e dyzetë e shtatë) leke.

4. Vlera e dëmit është përlogaritur nga Komisioni i Vleresimit të dëmeve, të Bashkisë Mallakastër, ngritur me Urdhër nr.237 datë 23.06.2026 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.
5. Bazuar në ligjin 45, datë 18.07.2019 neni 41 "E drejta e kompesimit", pika 2, në të cilën thuhet "Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile.
6. Ndiurma financiare për familjen e qytetarit Ramadan Meçaj përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat dhenies se ndihmes shtetore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore". Bazuar ne përputhje me çmimet aktuale mesatare të investiguara nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier "Cmimet e investiguara për mobilje, elektroshtëpiake, cmimet sipas zërave të punës nga ana ndërtimore".

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

